

SYLLABUSI: KONTABILITET

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Kontabilitet
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I-rë, semestri II-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6 ECTS
Koha / lokacioni:	Prishtinë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.dr. Skender Ahmeti, Prof.dr. Nexhmije Berisha – Vokshi
Detajet kontaktuese:	Të gjitha kontaktet me profesorë dhe asistentë studentët mund t'i kenë edhe përmes e-mailit zyrtar: emri.mbiemri@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kontabiliteti shtjellon, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik: • Njohuritë e përgjithshme mbi sistemin e kontabilitetit dhe procedurave për krijimin e informacionit kontabël, • Format e regjistrimit të transaksioneve, • Aplikimin e kontabilitetit të dyfishtë, • Elemente e pasqyrave financiare, • Kompletimi i ciklit të kontabilitetit, • Njohjen e të ardhurave, shpenzimeve, • Kontabilitetin e kompanive tregtare, gjendjen e mallrave dhe regjistrimi i tyre, Kontabiliteti i aseteve fikse dhe të paprekshme etj.
Qëllimet e lëndës	✓ Fitimi i njohurive të reja të natyrës teorike dhe praktike nga fusha e kontabilitetit. ✓ Ofrimi i mundësive reale për krijimin e kuadrit profesional për zbatimin e njohurive të fituara kontabile, për njohjen, përpunimin, regjistrimin e transaksioneve financiare të subjektet afariste si dhe ✓ Krijimin e pasqyrave financiare dhe dokumenteve përcjellëse.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të jetë në gjendje që të: 1. Krijojnë informacionin kontabël për marrjen e vendimeve afariste, 2. Njohin dhe regjistrojnë transaksionet financiare si dhe përpilimin e pasqyrave financiare dhe dokumenteve përcjellëse, 3. Njohin dhe kontabilizojnë shpenzimet, të ardhurat dhe rezultatin financiar të subjekteve, varësisht nga niveli i biznesit duke u mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Kosovare të Kontabilitetit (SKK), 4. Thellojnë njohuritë për përcjelljen kontabël të mjeteve dhe burimeve të mjeteve, 5. Thellojnë njohuritë për mënyrën e financimit të subjektit, ruajtjes së substancës së subjektit dhe raportimit të ndryshimeve në ekuitet, etj.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	2	5	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1	6
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume, seminare	-	-	-
Detyra të shtëpisë	2	10	20
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	-	-	31
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuize,provim final).	3	3	9
Projektet, prezantimet ,etj	-	-	4
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Mësimdhënia do të zhvillohet përmes ligjëratisë, detyrave praktike, interpretimeve individuale e grupe, vetëvlerësimeve periodike, etj. Të gjitha këto do të realizohen në aspektin teorik dhe praktik duke i prezantuar materialet në formën audio-vizuale përmes teknologjisë elektronike me programet e Windows Office. Në aspektin teorik do të ofrohen njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore. Pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe nga njohuritë praktike të ndërmarrjet profitabile. Në këtë mënyrë do të synohet krijimi i raporteve ndërvepruese profesor–student si dhe ai student-student.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve do të bëhet në bazë:		
	✓ të vijueshmërisë dhe angazhimit të tyre,		
	✓ detyrave me shkrim,		
	✓ suksesit në kollokviume si dhe provimit përfundimtar.		
	91-100% nota 10 (dhjete)		
	81-90% nota 9 (nëntë)		
	71-80% nota 8 (tetë)		
61-70% nota 7 (shtatë)			
51-60% nota 6 (gjashtë)			
50-less nota 5 (pesë)			
Literatura			
Literatura bazë:	1. Prof.dr.Skender Ahmeti: “Kontabiliteti Financiar, (koncepte themelore)” Prishtinë, 2012		
	2. Prof.asoc.dr.Rrustem Asllanaj: ”Kontabiliteti financiar”, Prishtinë, 2013		
Literatura	1. King, Lemble & Smith: “ Financial accounting – A decision making		

shtesë:	approach” Second Edition, John Wiley and Sons, New York, 2001 2. John Wild:”Financial accounting – Information for decision “ Third Edition, McGraw – Hill, 2005
----------------	--

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezantim i kontabilitetit dhe bizneseve (Skender Ahmeti: Kontabiliteti financiar (koncepte themelore) fq. 10- 45
Java e dytë:	Prezantim i pasqyrave financiare (Aty, fq. 54-86)
Java e tretë:	Ekuacioni i kontabilitetit të dyfishtë (Aty, fq.98-124)
Java e katërt:	Analiza dhe regjistrimi i transaksioneve në biznes (Aty, fq. 136-107)
Java e pestë:	Rrjedha e transaksioneve në biznes (Aty, fq. 107-124)
Java e gjashtë:	Kompletimi i ciklit të kontabilitetit (Aty, fq.136-159)
Java e shtatë:	Regjistrimet rregulluese (Aty, fq.160-173)
Java e tetë:	Testi i parë
Java e nëntë:	Kontabiliteti i veprimtarive tregtare (Aty, fq.187-200)
Java e dhjetë:	Blerja dhe shitja e mallrave dhe shërbimeve (Aty, fq.201-221)
Java e njëmbëdhjetë:	Inventari i mallit dhe KMSH (Aty, fq.233-238)
Java e dymbëdhjetë:	Metodat për përcaktimin e kostos së inventarit (Aty, fq.239-261)
Java e trembëdhjetë:	Raportimi dhe analizimi i pasurisë afatgjatë (Aty, fq.297-328)
Java e katërmëdhjetë:	Raportimi dhe analizimi i pasurisë së paprekshme (Aty, fq.328-337)
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t’u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrohen vlerësimeve gjatë semestrit. Studentët inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutime lidhur me to. Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t’i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.